# DËSHMI ARKIVI

**A-475547**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 2

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Florin dhe Eris, çifti që priste një fëmijë, por u shua nën rrënojat e Athinës |
| ADRESA | `https://joq-albania.com/artikull/1394590.html` |
| BURIMI | joq-albania.com |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 28 shtator 2026, 08:57:08 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| LEXUAR NGA FAQJA | 28 shtator 2026, 08:55:00 UTC<br>*Portali nuk e deklaron datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me metodën **text_date**. Dritarja: 28 shtator 2026, 08:54:00 UTC → 28 shtator 2026, 08:56:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `e7bf3b108647a2b1bf9837a9287a63ebbf1b541824d672c3e4c0cc27dd93e6da` |
| TEKSTI | `ead4b78c717fe52ae083caa363db886c20804bb4cd1a620ba1482f96f1836245` |
| PAMJA | `2a4ab12dff2807b026fd672ebffeaaac7974651a0fbca57dd8b532eb34dbbd05` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `16ab01fc340e89906cbf95b7365b23526bc5abe851eb0731d24c04ec43654f14` |
| E MËPARSHMJA | `caa589ccb63a1d27f6361f31ccbf2b2424e241789b207bde6c4a850fd2cbd030` |
| RRËNJA MERKLE | `b28949f398f9c40f36f567d35f036ed2a879d9ccf77f144b0ee032f95e15789d` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/16ab01fc340e89906cbf95b7365b23526bc5abe851eb0731d24c04ec43654f14`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Florin dhe Eris, çifti që priste një fëmijë, por u shua nën rrënojat e Athinës

Shkruar nga: I Cani | Publikuar më: 28.09.2026, 10:55

Share Share



Dy ditë më parë, një shpërthim i fuqishëm tronditi zemrën e Athinës dhe shembi një godinë në zonën e Plakës. Pas orëve të kërkimeve, nën rrënoja u gjetën gjashtë viktima, mes tyre edhe tre shqiptarë.

Mes tyre ishin Eris Cani dhe bashkëshorti i saj, Florin Hoxha.

Por pas emrave të tyre fshihet një tjetër dimension i dhimbshëm i kësaj tragjedie. Eris dhe Florin po prisnin fëmijën e tyre të parë. Sipas raportimeve të mediave greke dhe dëshmive të një miku të familjes, Eris ishte rreth tre muajshe shtatzënë.

Ata kishin udhëtuar drejt Greqisë së bashku me çiftin tjetër, Florida Hoxha dhe Ian Alexander Kirkpatrick, të cilët gjithashtu humbën jetën në tragjedi. Florida dhe Iani ishin martuar së fundmi dhe ndodheshin në Greqi për muajin e mjaltit.

Dy çifte, katër jetë dhe një udhëtim që duhej të mbetej një kujtim i bukur, u kthyen në një prej tragjedive më të rënda për familjet e tyre.

Për Erisin dhe Florinin, dhimbja është e pakthyeshme. Ata nuk do ta shohin kurrë fëmijën që prisnin dhe nuk do ta dëgjojnë kurrë të thërrasë "mami" dhe "babi".

Në të njëjtën godinë humbën jetën edhe Athena Paparescu dhe Edmond Hings, të dy 77 vjeç. Hetimet greke vijojnë për të zbardhur shkaqet e shpërthimit dhe shembjes së ndërtesës. Pista e rrjedhjes së gazit është ndër mundësitë që po shqyrtohen, por autoritetet ende nuk kanë përcaktuar përfundimisht shkakun.

Athina i mori gjashtë jetë. Por historia e Erisit dhe Florinit mbetet edhe më e dhimbshme: një çift që po priste të sillte në jetë një fëmijë, por që nuk pati mundësinë ta takonte kurrë.

**FACT CHECK:** Synimi i JOQ Albania është t'i paraqesë lajmet në mënyrë të saktë dhe të drejtë. Nëse ju shikoni diçka që nuk shkon, jeni të lutur të na e raportoni këtu.

JOQ Sondazh
KLIKO PËR TË VOTUAR



Më të Lexuarat

Aleanca për Media Etike
ARTIKULL JOETIK?




Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.